Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 22 gusht 2012

Lënda nr. 85/10

B. K.

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 22 gusht 2012, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
z. Paul LEMMENS
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas konsiderimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 30 mars 2010 dhe është regjistruar më 22 prill 2010.

2. Më 29 dhjetor 2010, ankuesi i parashtroi Panelit informata të tjera.

3. Më 16 mars 2012, paneli ia komunikoi lëndën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) lidhur me marrjen e komenteve të UNMIK-ut për pranueshmërinë e ankesës. PSSP-ja dha përgjigjen e vet më 21 maj 2012.

4. Më 14 maj 2012, Paneli ia komunikoi PSSP-së dokumentacionin shtesë dhe ftojë UNMIK-un të jep komente të tjera për pranueshmërinë e lëndës në dritën e dokumenteve të pranuara. Më 21 maj 2012, Paneli pranoi përgjigjen e UNMIK-ut.

II. FAKTET

5. Ankuesi është lindur në Kosovë në vitin 1954. Në vitin 1985 kishte shkuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), ku ka jetuar dhe punuar gjatë 23 viteve pasuese.

6. Ankuesi thotë se në vitin 1990, pas zhvillimeve politike në regjion të ish-Jugosllavisë, ai parashtroi kërkesën për azil tek autoritetet e ShBA-së. Mirëpo, ai asnjëherë nuk kishte marrë ndonjë përgjigje lidhur me këtë kërkesë.

7. Në vitin 2004, autoritetet ShBA-së për imigracion filluan procedurat e largimit të ankuesit për shkak të pretendimeve se ai kishte qëndruar në ShBA më shumë se sa që parashihej në vitin 1985, duke shkelur kështu ligjet e imigracionit të ShBA-së. Ankuesi thotë se është mbajtur në mënyrë të paligjshme në arrest për afro katër vite gjatë procedurave për largimin e tij dhe se në fund të procedurës dhe pas ankesës së parashtruar, ai iu nënshtrua largimit nga ShBA-ja.

8. Më 6 maj 2008, pas lëshimit të dokumentit të udhëtimit nga UNMIK-u, ankuesi është deportuar nga ShBA-ja në Kosovë. Ankuesi thotë se pas deportimit, atij nuk i është dhenë ndihma nga UNMIK-u apo nga ndonjë autoritet tjetër lidhur me plotësimin e nevojave të tij themelore të jetesës dhe me riintegrimin e tij në shoqërinë e Kosovës. Ankuesi, i cili vuan nga një gjendje shëndetësore që nga lindja, deklaron se mospasja e qasjes në ushqim, banim dhe kujdes mjekësor të mirë ia ka përkeqësuar gjendjen. Ai më tej thotë se nga 30 maji 2008, i ka shkruar letra dhe është përpjekur t'ua adresojë kërkesat e tij zyrtarëve të lartë të UNMIK-ut, mirëpo nuk ka marrë ndonjë njoftim për pranim apo përgjigje.

9. Në parashtresat e tij dërguar Panelit, ankuesi po ashtu thotë se më 13 tetor 2010, pasi që mjeku kishte vërtetuar paaftësinë e tij të punës, ai ka parashtruar kërkesë për pension invalidor tek ministria përkatëse e Kosovës. Më vonë ai është njoftuar me gojë se kërkesa e tij është refuzuar.

III. ANKESA

10. Ankuesi ankohet se UNMIK-u ka lehtësuar deportimin e tij në Kosovë pas një qëndrimi të vazhdueshëm prej njëzet e tri viteve në ShBA, duke mos i dhënë ndihmesë pas arritjes në Kosovë. Ai pretendon se pas deportimit, nuk kishte strehim dhe ushqim të duhur; nuk kishte qasje të duhur në kujdes social dhe shëndetësor, në punë apo në mjete financiare për ta mbajtur vetveten.

11. Në këtë drejtim, Paneli konsideron se mund të konsiderohet se ankuesi thirret në shkeljen e së drejtës së tij për të mos u trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe poshtëruese, e cila parashihet në nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj),

si dhe në shkeljen e së drejtës së tij për punë, sigurim social dhe për standard të duhur të jetesës, ashtu siç përkatësisht parashihet në nenet 6, 9 dhe 11 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK).

12. Ankuesi po ashtu ankohet se pavarësisht gjendjes së tij shëndetësore dhe paaftësisë për punë, siç është përcaktuar nga mjeku, Qeveria e Kosovës nuk i ka garantuar atij pension invalidor.

IV. LIGJI

13. Para shqyrtimit të lëndës për bazueshmërinë e saj, Paneli fillimisht duhet të vendosë nëse duhet të pranohet lënda apo jo, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë, të parapara në nenin 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

A. Lidhur me atë se a është parashtruar ankesa me kohë

14. Që në fillim, PSSP-ja thotë se ankesa është e papranueshme pasi që është parashtruar pas datës së fundit, gjegjësisht datës 31 mars 2010, të paraparë me Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2009/01 të datës 17 tetor 2009 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut. PSSP-ja argumenton se asnjë ankesë nuk është e pranueshme nëse pranohet nga Sekretaria e Panelit më vonë se më datën 31 mars 2010, ndërsa ankesa në fjalë ka vulën e regjistrimit më datë 22 prill 2010.

15. Paneli thekson se ka qenë praktikë e tij e përhershme që në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, të konsideron si vendimtare datën e parashtrimit apo të dërgimit me postë të ankesës në Panel, dhe jo datën kur ankesa regjistrohet apo pranohet (shih, përshtatshmërisht, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj), *Kipritci kundër Turqisë*, nr. 14294/04, vendim i datës 3 qershor 2008, § 18).

16. Paneli thekson se në rastin në fjalë, data e parashtrimit të ankesës është 30 mars 2010, një ditë para datës së fundit, të përcaktuar përmes Udhëzimit administrativ të UNMIK-ut nr. 2009/01. Për këtë arsye, Paneli e refuzon vërejtjen e ngritur nga PSSP-ja.

B. Ankesa lidhur me mosekzistimin e pretenduar të ndihmesës pas deportimit

17. Siç është theksuar më lartë, ankuesi thotë se pas deportimit të tij në Kosovë ai nuk ka marrë ndonjë ndihmesë nga UNMIK-u për t'i plotësuar nevojat e veta themelore lidhur me banimin, ushqimin, ndihmën sociale dhe kujdesin e duhur shëndetësor. Ai thotë se vuan nga një gjendje shëndetësore që nga lindja dhe se shëndeti i tij është përkeqësuar për shkak të kushteve të dobëta të jetesës pas kthimit në Kosovë. Ai gjithashtu ankohet se UNMIK-u nuk i ka dhënë ndihmesë në mënyrë që ai të riintegrohet në shoqëri dhe të gëzojë një standard normal të jetesës.

18. Në komentet e tij për pranueshmëri, PSSP-ja deklaron se UNMIK-u ka lehtësuar deportimin e ankuesit, përndryshe banorit të Kosovës, duke ia lëshuar dokumentin e udhëtimit "të nxjerrë vetëm me qëllim të ofrimit dokumentit të udhëtimit për bartësin për t'u përdorur në cilësinë e pasaportës nacionale". PSSP-ja gjithashtu deklaron se ankuesi ka ardhur në Kosovë më 6 maj 2008 dhe për herë të parë ka kontaktuar autoritetet e UNMIK-ut për ndihmesë më 30 maj 2008. Sipas pikëpamjes së PSSP-së, UNMIK-u nuk ka pasur kohë të mjaftueshme që t'ia vinte atij në dispozicion punën, sigurimin social dhe një standard të duhur të jetesës, duke marrë parasysh se UNMIK-u ka pushuar së ushtruari të kompetencave ekzekutive në Kosovë më datën 15 qershor 2008, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës. PSSP-ja argumenton se për këtë arsye, kjo pjesë e ankesës është e papranueshme *ratione personae*.

19. Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut lidhur me obligimet e shteteve sipas nenit 3 të KEDNj-së përkitazi me personat e cenueshëm dhe me anëtarët e grupeve posaçërisht të nënprivilegjuara dhe të cenueshme – atyre që kanë nevojë për mbrojtje të posaçme. Gjykata nuk ka përjashtuar "mundësinë e kërkimit të përgjegjësisë nga shteti [sipas nenit 3] lidhur me trajtimin në rastet kur paditësi, i cili ka qenë tërësisht i varur nga përkrahja e shtetit, e ka gjetur vetveten të ballafaquar me indiferencë zyrtare nga shteti në një gjendje të privimit të rëndë apo dëshirës së madhe që nuk është në përputhje me dinjitetin njerëzor" (shih GjEDNj, *Budina kundër Rusisë*, nr. 45603/05, vendimi i datës 18 qershor 2009; GjEDNj (Dhoma e lartë), *M.S.S. kundër Belgjikës dhe Greqisë*, nr. 30696/09, aktgjykimi i datës 21 janar 2011, §§ 251-253).

20. Lidhur me vërejtjen e PSSP-së se UNMIK-u nuk ka qenë kompetent *ratione personae* që atij t'i ofrojë ndihmesë pas deportimit, Paneli tani më ka konstatuar, se pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, më datën 15 qershor 2008, UNMIK-u më nuk ka qenë në gjendje që në mënyrë të efektshme t'i zbatojë shumicën e detyrave të tij në cilësinë e administratës së përkohshme, dhe se PSSP-ja nuk ka qenë në gjendje të zbatojë autoritetin ekzekutiv, të cilin ende e ka zyrtarisht sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (shih, p.sh., Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, të datës 12 qershor 2008, S/2008/354, §§ 7 dhe 17; Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë të datës 15 korrik 2008, S/2008/458, §§ 3-4 dhe 29; Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë të datës 24 nëntor 2008, S/2008/692, § 21).

21. Paneli tani më ka marrë parasysh se si rezultat i kësaj që nga data 15 qershor 2008, në parim UNMIK-u nuk mund të konsiderohet përgjegjës për veprat apo lëshimet që i atribuohen autoriteteve të Kosovës (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut (PKDNj), *Ibrahimi*, nr. 86/10, vendim i datës 16 mars 2012, § 11).

22. Megjithatë, Paneli thekson se në rastin në fjalë, ankuesi është deportuar nga ShBA-ja në Kosovë më 6 maj 2008 dhe se deportimi është lehtësuar nga UNMIK-u. Paneli konsideron se edhe kjo duhet të ngrejë përgjegjësi për ofrimin e së paku një ndihmese

minimale fillestare dhe këshillave individëve që i nënshtrohen deportimit në Kosovë. Në bazë të kësaj, Paneli refuzon vërejtjen e ngritur nga PSSP-ja.

23. Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës ngritë çështje serioze të fakteve dhe të ligjit, përcaktimi i të cilave duhet të varet në shqyrtimin e bazueshmërisë. Rrjedhimisht, Paneli vjen në përfundim se kjo pjesë e ankesës në shikim të parë nuk është e pabazuar në bazë të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

24. Nuk është përcaktuar ndonjë bazë tjetër për shpalljen e kësaj ankese si të papranueshme.

C. Ankesa lidhur me kërkesën për pension invalidor

25. Ankuesi gjithashtu ankohet se në një datë të paspecifikuar pas 13 tetorit 2010, ai është informuar me gojë se Ministria ia kishte refuzuar kërkesën për pension invalidor.

26. Paneli përkujton se në bazë të nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Paneli ka kompetenca ndaj ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u.

27. Përkitazi me këtë pjesë të ankesës, Paneli përkujton arsyetimin e tij (§§ 20-21) se që nga data 15 qershor 2008, UNMIK-u në parim nuk mund të konsiderohet përgjegjës për veprimet apo lëshimet që i atribuohen autoriteteve të Kosovës.

28. Paneli thekson se objekti i kësaj pjese të ankesës është vendimi që ekskluzivisht i atribuohet autoriteteve të Kosovës. Nuk ka indikacion të çfarëdo përfshirjeje konkrete të UNMIK-ut në marrjen e atij qëndrimi. Po ashtu, nuk ka rrethana të posaçme që do nxisnin moszbatimin e parimit të cekur më lartë. Andaj, mund të vihet në përfundim se çështja specifike, ndaj së cilës është parashtruar ankesa nuk ngritë përgjegjësi të UNMIK-ut (PKDNj, *Ibrahimi*, cituar në § 21 më lartë, në § 12).

29. Rrjedhimisht, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit.

Për këto arsye,

Paneli, njëzëri,

- **SHPALL TË PRANUESHME ANKESËN LIDHUR ME MUNGESËN E PRETENDUAR TË NDIHMESËS PAS DEPORTIMIT;**

- **SHPALL TË PAVLEFSHME PJESËN TJETËR TË ANKESËS.**

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues